



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
AGJENCIA KOMBËTARE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR

LISTË VERIFIKIMI PËR Udhëzimin nr.21, datë 18.8.2016 “Për organizimin dhe funksionimin e gjimnazit me kohë të pjesshme”

Nr.

Datë:

Qarku:

Subjekt i inspektuar për herë të:

1. TË DHËNA TË PËRGJITHSHME TË SUBJEKTIT

1.	Emri i Subjektit	
2.	Data e Fillimit të aktivitetit	
3.	Lloji i aktivitetit ekonomik	
4.	Adresa - Qendër (Rrugë, Njësi, Telefon)	
5.	Adresa të tjera - Filiale (Rrugë, Njësi, Telefon)	
6.	Përfaqësuesi i subjektit (emër, atësia, mbiemri)	
7.	NUIS - QKR (Nr Unik i Identifikimit)	
8.	Tipi i Pronësisë	Tipi i Subjektit

LISTË VERIFIKIMI PËR Udhëzimin nr.21, datë 18.8.2016 “Për organizimin dhe funksionimin e gjimnazit me kohë të pjesshme”

Subjekti:

Nr.NIPT:

Adresa:

Administratori:

Drejtori i shkollës:

Tel/Cel:

Fax:

E-mail:

Lloji Aktivitetit:(Kopsht/AB/AML)

Në zbatim të udhëzimit nr. 21, datë 18.8.2016 “Për organizimin dhe funksionimin e gjimnazit me kohë të pjeshme”, i ndryshuar me udhëzimin nr. 23, datë 26.09.2016.

Nr	Baza Ligjore	Pyetje	Vlerësimi (Po/Jo/Nuk Aplikohet)	Komente
1	Pika 1, neni 1, udhëzimi nr. 21, datë 18.08.2016.	A është organizuar gjimnazi me kohë të pjeshme (GJKP), në çdo njësi arsimore vendore, e cila, me vendim të posaçëm, cakton 1 (një) institucion arsimor që ofron gjimnazin me kohë të pjeshme?		
2	Pika 1, neni 1, udhëzimi nr. 21, datë 18.08.2016.	A zgjat gjimnazi me kohë të pjeshme 4 (katër) vite shkollimi dhe funksionon me tri ditë në javë?		
3	Pika 3, neni 1, udhëzimi nr. 21, datë 18.08.2016.	A funksionon gjimnazi me kohë të pjeshme në qytetin qendër të njësisë arsimore vendore?		
4	Pika 4, neni 1, udhëzimi nr. 21, datë 18.08.2016.	A funksionon gjimnazi me kohë të pjeshme si institucion arsimor i veçantë, kur numri i nxënësve të regjistruar është mbi 300?		
5	Pika 5, neni 1, udhëzimi nr. 21, datë 18.08.2016.	A ka krijuar drejtorja e shkollës dokumentacion shkollor të veçantë (amzë, indeks amze dhe regjistër klase) për dokumentimin e realizimit të procesit mësimor, kur GJKP-ja funksionon në një gjimnaz me kohë të plotë?		
6	Pika 6, neni 1, udhëzimi nr. 21, datë 18.08.2016.	A është hartuar nga IZHA-ja dhe miratuar nga ministri i Arsimit dhe Sportit plani mësimor dhe udhëzimi për zbatimin e programeve lëndore të GJKP-së?		

Nr	Baza Ligjore	Pyetje	Vlerësimi (Po/Jo/Nuk Aplikohet)	Komente
7	Pika 7, neni 1, udhëzimi nr. 21, datë 18.08.2016.	A është përcaktuar ngarkesa mësimore e mësuesve dhe numri i nxënësve për klasë, sipas akteve nënligjore në fuqi?		
8	Neni 2, udhëzimi nr. 21, datë 18.08.2016.	A i është dhënë e drejta nxënësit që ka mbushur moshën njëzet e një vjeç dhe nuk e ka përfunduar gjimnazin, për të vijuar gjimnazin me kohë të pjesshme?		
9	Neni 3, udhëzimi nr. 21, datë 18.08.2016.(# me udhëzimin nr. 23/16).	A i është dhënë e drejta nxënësit që ka dëftesën e lirimit, të fituar brenda vendit ose një dëftesë të njëvlershme me të, të fituar jashtë vendit, dhe është mbi 18 vjeç, ditën e fillimit të vitit shkollor, për tu regjistruar në klasën e dhjetë të gjimnazit me kohë të pjesshme?		
10	Pika 1, neni 4, udhëzimi nr. 21, datë 18.08.2016.	A i është dhënë e drejta nxënësit që ka fituar dëftesën e klasës së dhjetë të gjimnazit me kohë të plotë brenda vendit, për t'u regjistruar në klasën e njëmbëdhjetë të gjimnazit me kohë të pjesshme?		
11	Pika 2, neni 4, udhëzimi nr. 21, datë 18.08.2016.	A i është dhënë e drejta nxënësit që ka përfunduar klasën e njëmbëdhjetë të gjimnazit me kohë të plotë brenda vendit, për t'u regjistruar në klasën e trembëdhjetë të gjimnazit me kohë të pjesshme, nëse rezulton kalues në provimet që duhet të japë për klasën e 12-të?		
12	Pika 2, neni 4, udhëzimi nr. 21, datë 18.08.2016	Për lëndët mësimore të klasës së 12-të a i janë bartur rezultatet e klasës së 11-të gjimnazit me kohë të plotë?		
13	Pika 2, neni 4, udhëzimi nr. 21, datë 18.08.2016	A i ka dhënë provim lëndët e tjera të planit mësimor të klasës së 12-të me kohë të pjesshme?		
14	Pika 3, neni 4, udhëzimi nr. 21, datë 18.08.2016.	A është regjistruar në klasën e 11-të,dhe/ose të 12-të të gjimnazit me kohë të pjesshme nxënësi që ka fituar dëftesën e klasës së 10-të dhe/ose të 11-të të gjimnazit me kohë të plotë,(sistemi 4-vjeçar), nëse rezulton kalues në provimet e lëndëve të munguara nga plani mësimor i GJKP-së?		

Nr	Baza Ligjore	Pyetje	Vlerësimi (Po/Jo/Nuk Aplikohet)	Komente
15	Pika 4, neni 4, udhëzimi nr. 21, datë 18.08.2016.	A është regjistruar në klasën e 11-të të GJKP-së nxënësi që ka fituar dëftesën e klasës së 10-të të arsimit të mesëm profesional, dhe rezulton kalues në provimet e lëndëve të munguara të planit mësimor të klasës së 10-të të GJKP-së?		
16	Pika 4, neni 4, udhëzimi nr. 21, datë 18.08.2016	A është marrë vendimi për numrin e lëndëve të munguara, për të cilat duhet të merret në provim nxënësi, nga drejtoria e shkollës?		
17	Pika 5, neni 4, udhëzimi nr. 21, datë 18.08.2016.	A janë zhvilluar provimet që organizon gjimnazi me kohë të pjesshme për regjistrimin/et në klasat e ndërmjetme, brenda muajit shtator?		
18	Germa a, pika 1, neni 5, udhëzimi nr. 21, datë 18.08.2016.	A ka paraqitur nxënësi në institucionin shkollor (GJKP) kopjen e dokumentit të identifikimit, për t'u regjistruar në klasën e dhjetë të gjimnazit me kohë të pjesshme?		
19	Germa b, pika 1, neni 5, udhëzimi nr. 21, datë 18.08.2016.	A ka paraqitur nxënësi në institucionin shkollor (GJKP) dëftesën e lirit ose, në mungesë të saj, vërtetimin origjinal me nota dhe me fotografi, lëshuar nga drejtori i shkollës dhe konfirmuar nga DAR/ZA-ja, ose kopjen e faqes së plotë të amzës, lëshuar nga zyra e Arkivit të Shtetit, për t'u regjistruar në klasën e dhjetë të gjimnazit me kohë të pjesshme?		
20	Germa a, pika 2, neni 5, udhëzimi nr. 21, datë 18.08.2016.	A ka paraqitur nxënësi në institucionin shkollor (GJKP) kopjen e dokumentit të identifikimit për t'u regjistruar në klasën e ndërmjetme të gjimnazit me kohë të pjesshme?		
21	Germa b, pika 2, neni 5, udhëzimi nr. 21, datë 18.08.2016.	A ka paraqitur nxënësi në institucionin shkollor (GJKP) për t'u regjistruar në klasën e ndërmjetme, dëftesën/at e përfundimit të klasës/ave paraardhëse ose, në mungesë, vërtetimin origjinal me nota dhe me fotografi, lëshuar nga drejtori i shkollës dhe konfirmuar nga DAR/ZA-ja përkatëse?		
22	Pika 3, neni 5, udhëzimi nr. 21, datë 18.08.2016.	A është realizuar regjistrimi i nxënësve në të gjitha klasat e gjimnazit me kohë të pjesshme, deri 1 (një) ditë para fillimit të vitit shkollor?		

Nr .	Baza Ligjore	Pyetje	Vlerësimi (Po/Jo/Nuk Aplikohet)	Komente
23	Pika 3, neni 5, udhëzimi nr. 21, datë 18.08.2016	A janë kryer rastet e veçanta të regjistrimit në të gjitha klasat e gjimnazit me kohë të pjesshme, me vendim të arsyetuar të njësisë arsimore vendore?		
24	Pika 1, neni 6, udhëzimi nr. 21, datë 18.08.2016.	A është realizuar vlerësimi i arritjeve të nxënësve në gjimnazin me kohë pjesshme sipas formave dhe metodologjive që zbatohen për vlerësimin e arritjeve të nxënësve në gjimnazin me kohë të plotë?		
25	Pika 2, neni 6, udhëzimi nr. 21, datë 18.08.2016.	A janë vlerësuar nxënësit e klasës së 10-të, të vitit shkollor 2016–2017, sipas metodologjisë së vlerësimit të përcaktuar në udhëzimin e MAS-it nr. 14, datë 28.7.2016, “Për vlerësimin e nxënësve në arsimin e mesëm të lartë”?		
26	Pika 3, neni 6, udhëzimi nr. 21, datë 18.08.2016.	A janë zhvilluar provimet për efekt të njëvlershmërisë vetëm me shkrim?		
27	Pika 3, neni 6, udhëzimi nr. 21, datë 18.08.2016	A janë hartuar dhe vlerësuar provimet e njëvlershmërisë nga komisionet lëndore, të miratuara me vendim të drejtorisë së shkollës?		
28	Pika 4, neni 6, kreu I, udhëzimi nr. 21, datë 18.08.2016.	A janë monitoruar nga njësia arsimore vendore çdo fazë e provimeve me shkrim, që zhvillohen në gjimnazin me kohë të pjesshme?		
29	Pika 5, neni 6, kreu I, udhëzimi nr. 21, datë 18.08.2016.	A janë ruajtur provimet e nxënësve sipas akteve nënligjore në fuqi për të qenë objekt i inspektimit?		
30	Pika 1, neni 7, kreu I, udhëzimi nr. 21, datë 18.08.2016.	A është klasifikuar pakalues në një lëndë, nxënësi që ka munguar më shumë se 50% të orëve mësimore vjetore të kësaj lënde?		
31	Pika 2, neni 7, kreu I, udhëzimi nr. 21, datë 18.08.2016.	A është klasifikuar mbetës në klasë, nxënësi që mungon më shumë se 30% të orëve vjetore të planit mësimor?		
32	Pika 3, neni 7, kreu I, udhëzimi nr. 21, datë 18.08.2016.	A është marrë në provim me shkrim nga mësuesi i lëndës për temat e programit mësimor që ka munguar, nxënësi që ka munguar deri në 50% të orëve mësimore vjetore të një lënde?		

Nr	Baza Ligjore	Pyetje	Vlerësimi (Po/Jo/Nuk Aplikohet)	Komente
33	Pika 3, neni 7, kreu I, udhëzimi nr. 21, datë 18.08.2016.	A janë vendosur notat e çdo provimi për nxënësin që ka munguar deri në 50% të orëve mësimore vjetore të një lënde, në shtylla të veçanta të regjistrit që u përkasin notave për kapitull/kapituj?		
34	Pika 4, neni 7, kreu I, udhëzimi nr. 21, datë 18.08.2016.	A janë caktuar nga mësuesi i lëndës dhe miratuar nga drejtori i shkollës datat e provimeve, për detyrimin sipas pikës 3 të këtij neni?		
35	Pika 1, neni 8, kreu I, udhëzimi nr. 21, datë 18.08.2016.	A ka filluar zbatimin e planit mësimor i GJKP-së nr. 7380 prot., datë 20.7.2016, i miratuar nga MAS-i, në klasën e 10-të të vitit shkollor 2016–2017?		
36	Germa a, neni 9, udhëzimi nr. 21, datë 18.08.2016.	A ka përcaktuar njësia arsimore vendore gjimnazin me kohë të pjesshme?		
37	Germa b, neni 9, udhëzimi nr. 21, datë 18.8.2016.	A ka miratuar njësia arsimore vendore, ditët e javës për zhvillimin e mësimin sipas propozimit të drejtorit të gjimnazit me kohë të pjesshme?		
38	Germa c, neni 9, udhëzimi nr. 21, datë 18.08.2016.	A ka kryer njësia arsimore vendore procedurën e njëvlershmërisë së dokumentacionit të nxënësve që vijnë nga jashtë vendit?		
39	Germa d, neni 9, udhëzimi nr. 21, datë 18.08.2016.	A e ka monitoruar njësia arsimore vendore gjimnazin me kohë të pjesshme, për procedurat e regjistrimit, të frekuentimit dhe procesin mësimor në tërësi?		

INSPEKTORËT